VENDIM
Nr. 70, datë 10.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GSA" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 275/4 prot., datë 6.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'GSA' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "GSA" sh.p.k., në datën 26.2.2026 ka paraqitur aplikimin për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe ka kryer pagesën që i korrespondon këtij aplikimi, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.
- Në vlerësimin e aplikimit për licencim është marrë në konsideratë edhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria në datën 26.1.2026 dhe janë bërë vlerësimet përkatëse në lidhje me afatet respektive të dokumentacionit apo vërtetimeve.
- Në këto rrethana, në rast licencimi të shoqërisë, vlefshmëria e licencës do të fillojë me përfundimin e afatit të licencës aktuale, pra më datë 24.6.2026.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se nga ana e shoqërisë nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, "Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë"

Pika 1.1: Shoqëria duhet të depozitojë shtojcën 1, të plotësuar në të gjithë zërat e saj, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 1.2, "Dokumentacioni juridik dhe administrativ":

- Germa "b": shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit për njërin nga administratorët e saj, pasi rezulton të jetë depozituar jashtë afatit të përcaktuar nga neni 8, pika 3 e rregullores, si dhe të depozitojë dëshminë e penalitetit për administratorin tjetër, që nuk rezulton të jetë depozituar në dosje.
- Germa "d": shoqëria duhet të depozitojë aktin e përfaqësimit për përfaqësuesin ligjor.

Pika 1.3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal":

- Germa "b": shoqëria duhet të saktësojë/korrigjojë sasitë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë dhe të depozitojë dokumentacionin vërtetues që provon disponimin e mbështetjes financiare të nevojshme për ushtrimin e të paktën 1 (një) muaj të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të saktësojë sasitë e energjisë elektrike për tregtimin në planin e biznesit, në referencë dhe të dokumentacionit tjetër të këtij aplikim, si dhe të përcaktojë mënyrën financimit të veprimtarisë.

Për sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GSA” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti